



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 332/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, për shkak të dërgimit të sms-ve, me thirrje për votim, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.332/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, t'i shqiptohet gjobë, për shkak të dërgimit të sms-ve, me thirrje për votim, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019.

#### A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.332/2019, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar, se nga ana e subjektit politik PDK, janë dërguar SMS, me thirrje për votim, në ditën e zgjedhjeve, dy orë pas mbylljes së vendvotimeve, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me nenin 36 par.1, pika b) të LZP-së, nenin 7 të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe nenin 8 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, duke propozuar që këto veprime të sanksionohen sipas legjisllacionit zgjedhor. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë, të datës 07.10.2019, ka theksuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, për arsye se fotoja që paraqitësi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, është e paqartë dhe nuk përmban argumente se nga kush është dërguar si dhe kush e ka pranuar sms-in, duke propozuar që PZAP-i, ta hudhë ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli nuk mundi të konstatoj se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur dispozita ligjore e LZP-së, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur dëshmi të qarta dhe bindëse për të argumentuar pretendimet e tija, se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). janë shkelur dispozitat e LZP-së dhe rregullave zgjedhore.

Nga fotografia e bashkangjitur si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet data, koha dhe as vendi i shkeljes së supozuar, ashtu siç edhe nuk mund të konstatohet se kush është dërguesi e kush është pranuesi i sms-it, koha e dërgimit. Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se në këtë rast ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as e rregullave zgjedhore, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik PDK, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, nenit 117 dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.332/2019 më datën 07.10.2019

**Kryesuese e Panelit**

Gyltana Sylejmani



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*